



## Stop dhunës!

### Informatë lidhur me dëbimin nga shtëpia dhe ndalimin e hyrjes në të në rast të dhunës shtëpiake – masat mbrojtëse civilo-juridike

Që nga 1 janari 2007 policia e Kantonit Aargau mund të dëbojë personat që ushtrojnë dhunë, nga banesa ose shtëpia dhe të ndalojë kthimin e tyre në shtëpi për maksimalisht 20 ditë. Me këtë synohet të pengohet dhuna e mëtejshme në mjedisin personal familjar, bashkëshortor ose të partneritetit. Gjatë periudhës së ndalim-hyrjes, personit të dëbuar nuk i lejohet të hyjë në banesë apo shtëpi, dhe as në rethinën e afërt, edhe në qoftë se personi i prekur nga dhuna shprehet dakort me kthimin. Nëse personi i dëbuar nuk e respekton ndalim-hyrjen, atëherë do të ndëshkohet me gjobë.

#### Për personat e prekur nga dhuna:

Pas intervenimit të policisë, zyra kundër ushtrimit të dhunës në shtëpi (Anlaufstelle gegen häusliche Gewalt Aargau) ju kontakton dhe ju ofron juve një këshillim si dhe ju ndërmjetëson tek një ent profesional i përshtatshëm. Ky shërbim është falas.

Në rast të një vepre penale ju keni të drejtë të shfrytëzoni Ndhimën për viktime. Në këtë rast policia – nëse ju e dëshironi këtë – ia transmeton drejtpërdrejt Ndhimës për viktime (Beratungsstelle Opferhilfe Aargau Solothurn) të dhënat tuaja personale. Pastaj këshilltarja ose këshilltari ju kontakton dhe ju ndihmon lidhur me veprimet e mëtejshme. Edhe ju vetë mund të kontaktoni Ndhimën për viktime (Tel. 062 835 47 90). Edhe ky këshillim është falas. Ndhima për viktime ju këshillon gjithashtu nëse dëshironi të kërkonim mbrojtje në Gjykatën e Qarkut (Bezirksgericht), kur bëhet fjalë për një mbrojtje që zgjat më shumë se sa ndalimi i hyrjes. Kërkesa duhet të parashtrohet para se të mbarojë periudha e ndalim-hyrjes.

Nëse personi i dëbuar nuk i përmbahet ndalim-hyrjes, atëherë thirrni menjëherë policinë (Tel. 117). Në qoftë se nuk ndiheni të sigurtë në shtëpi, atëherë mund të gjeni mbrojtje dhe strehim eventualisht tek familjarët dhe të afërmit, ose në njëren nga këto objekte strehuese: Frauenhaus (shtëpinë e grave, Tel. 062 823 86 00), ZwüscheHalt (tel. 079 558 85 79, strehim për burra të keqtrajtuar dhe femijët e tyre).

#### Për personat që ushtrojnë dhunë:

Dhuna nuk është një zgjidhje. Pas intervenimit të policisë, zyra kundër ushtrimit të dhunës në shtëpi (Anlaufstelle gegen häusliche Gewalt Aargau) ju kontakton ju dhe në të njëjtën kohë ju ofron një këshillim të shkurtër. Në mënyrë që në të ardhmën të evitohet çdo ushtrim i mundhëm i dhunës, së bashku me një ekspert do t'ju sqarohet se çfarë përkrahje ju duhet juve në rastet kur ushtrohet dhunë në shtëpi. Ju mundeni ta kontaktoni Këshillimoren edhe në ato raste kur policia ende nuk ka intervenuar (Tel. 062 550 20 20). Një këshillim i shkurtër është pa pagesë dhe i besueshëm.

Përveç kësaj, për të gjithë ata që shkaktojnë dhunë, ekziston mundësia që këta persona të marrin pjesë në një program mësimor apo në një këshillim individual që ka të bëjë me dhunën. Që të dy këto oferta duhet të paguhet por me një çmim të ultë. Zyra kundër ushtrimit të dhunës në shtëpi ju informon ju pa pagesë dhe në rast nevojë ju ofron mundësi tjera. Interesohuni dhe jeni të gatshëm për një përkrahje dhe ndihmë të tillë sepse nesër mund të jetë vonë.

#### **Adresat:**

**Adresat e ofertave më të rëndësishme për ndihmë në rast të dhunës në familje, mund t'i gjeni në fund të broshurës.**